



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 978/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 01.12.2013 në ora 18:58 nga parashtruesi i ankesës PDK ku ka pretenduar se, me dt. 01.12.2013 në ora 09:24, në gjimnazin “Shaban Hashani” e njëjta Qendër e Votimit QV 2502D janë keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it me qëllim të fitimit të votave nga Izet Rushiti koalicioni i LDK – AAK.

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimet e bëra janë në kundërshtim me Rregullat Zgjedhore nr.11/2013, neni 6 i Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët dhe neni 35 të LZP-së. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi 2 fotografi si provë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga PDK- ja pretendohet se janë keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it nga militantët e koalicionit LDK-AAK, ku Izet Rushiti me qëllim të përfitimit të votave për LDK-në ka keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it, mirëpo nga pretendimet e cekura nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar..

PZAP-i, konstatoi se pretendimet e tilla ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar, pasi që veturat e lartcekura nuk janë pronë publike por janë pronë KEDS-it për tepër nga dëshmitë e ofruara nuk mund të vërtetohet se janë bartur persona me veturat e KEDS-it, prandaj pasi që mungojnë provat bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar siç pretendohet në

ankesë PZAP-i bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 978/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi Paneli
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.